

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Gani Avdiu dhe Albert Zogaj, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve A. dhe F.S. e lindur Vuçitërna, që të dy të Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, për shkak të Kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Rahovec C.nr.208/2012 të datës 07.12.2012, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 13.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit , dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi Gjykatës Komunale në Rahovec, C.nr.208/2012 i datës 07.12.2012 në pjesën aprovuese.

II. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Rahovec, C.nr.208/2012 i datës 07.12.2012, në pjesën refuzuese, mbetet i pa prekur.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar në pikën pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia e paditësve dhe është obliguar e paditura që paditësve t'iu kompensoj në emër të dëmit jo material për shkak të vdekjes tragjike të birit të tyre A.S.2. dhe atë: në emër të dhimbjeve shpirtërore shumë prej nga 3.500 €, në emër të shpenzimeve të varimit shumë prej 1.700€ dhe në emër të ngritjes të përkujtimores shumë prej 1.500 €. Me të njëjtin dispozitiv është obliguar e paditura që paditësve shumë e cekura t'iu paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, ndërsa kërkesëpadinë e paditësve përtej shumë së aprovuar e ka refuzuar si të pabazë, duke e obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 530,00 € në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar, ashtu që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi së ti pabazuar ose ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësve i cili thekson se pretendimet ankimore të paditurës janë të pabazuara, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e kundërshtuar ta vërtetoj.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit A. dhe F.S. e lindur Vuçitërna, që të dy të Rahoveci, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahoveci, për shkak të kompensimit të dëmit, me të dhëna si në petitumin e precizimin e kërkesëpadisë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata në procedurën e provave ka bërë nxjerrjen e provave përmes leximit të konstatimit të Prokurorisë Publike të Qarkut PP.nr.143/2007 të datës 25.05.2007, ka bërë shikimin në certifikatën e lindjes nr.152 të datës 16.07.2007, në certifikatën e vdekjes nr.125 të datën 16.07.2007, në certifikatën e martesës nr.1544 të datës 18.07.2007, shikimin në raportin e mjekut të lëshuar nga Qendra e Mjekësisë Familjare, të datës 16.07.2007, leximin e ekspertizës të ekspertit të ndërtimtarisë V.K., shikimin në kontratën mbi dhënien me qira të lokalit afarist si dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore dr. C.M., dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së si dhe dispozitave të nenit 193, 200 dhe 201 të LMD-së dhe dispozitave të nenit 319 dhe 323 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, me arsyetim se nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë ka vërtetuar faktin se në ndërtesën ku ka ndodhur aksidenti, ku është rrëzuar oxhaku i ndërtesës në Rahovec është ndërtesë e vjetër, ndërsa nga parashtresa e Prokurorisë së Qarkut e cekur më lartë ka konstatuar se është fjala për vdekje aksidentale, ndërsa nga certifikata e lindjes në emër të A.S. ka vërtetuar faktin se i ndjeri ka lindur me datë 19.07.1995 na i ati Aburrahman dhe e ëma F.S., kurse nga certifikata e vdekjes e cekur më lartë ka vërtetuar faktin se A.S. ka vdekur 01.05.2007, kurse nga raporti mjekësor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare është konstatimi i mjekut i cili ka konstatuar vdekjen e birrit të paditësve. Nga ekspertiza e ekspertit të

ndërtimtarisë ka vërtetuar faktin në lidhje me gjendjen e oxhakut, për të cilin është cekur shkaku i rrëzimit të oxhakut, nga i cili ka humbur jetën aksidentalisht biri i paditësve. Nga kontrata mbi dhënien e lokalit afarist me qira ku është rrëzuar oxhaku, gjykata ka vërtetuar se Bordi i Drejtorëve i Komunës së Rahovecit si qiradhënës ia ka jep me qira Q.S. si qiramarrës me të cilin ka lidhur kontratën mbi shfrytëzimin e lokalit, i cili gjendet në katin përdhese të ndërtesës ku ka ndodhur aksidenti, e gjykata si fakt relevant për vendosjen e kësaj çështje kontestimore ka marrë për bazë se në mes të palëve në procedurë nuk është kontestues fakti se fëmiu i paditësve A.S.2., aksidentalisht ka humbur jetën me datë 01.05.2007, nga rrëzimi i oxhakut në ndërtesën e cila gjendet në qendër të Rahovecit, se e paditura është shfrytëzuese e lokalit afarist e cila gjendet në katin përdhes ku ka ndodhur aksidenti, e i cili fakt është vërtetuar edhe me kontratën e cekur më lartë mbi dhënien e lokalit afarist me qira.

Kjo gjykatë, duke e vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar, se ka mbështetje në dispozitat ligjore si dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore të paditësit, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndërsa e paditura edhe në ankesë nuk e konteston faktin se është pronare e lokalit afarist ku ka ndodhur aksidenti, në të cilin ka ndodhur rrëzuarja e oxhakut e në të cilin aksident ka humbur jetën biri i paditësve.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195.1 nën d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit gjykata vendosi që pjesa refuzuese të mbetet e pa prekur pasi që në këtë pjesë nuk ka pas ankesë.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.362/2013 më dt. 13.09.2016

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni,

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt. 13.09.2016, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

Vërtetojnë:**Anëtarët e kolegjit****Kryetari i kolegjit**

1. _____

2. _____